



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH. II.820/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesit të masës së sigurimit Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Shërbimeve Publike me seli në Prizren, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit V.I.Xh., kundër të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit NTSH Com Votra me NRB: 80638345 me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Blerim Bajrami avokat nga Suhareka, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërshtarit të sigurimit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.1002/23 datës 25.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 11.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kundërshtarit të sigurimit NTSH Com Votra me NRB 80638345 me seli në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.1002/23 i datës 25.01.2024, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KE.nr.1002/23 i datës 25.01.2024, ka vendosur si në vijim: I Aprovohet në tërsi si i bazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurimit Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Shërbimeve Publike, CAKTOHET masa e sigurimit në llogaritë bankare të kundërshtarit të sigurimit NTSH Com Votra, dhe i NDALOHET kundërshtarit të masës së sigurimit NTSH Com Votra, që të tjetërsoj, fshehë, ngarkoj apo të disponoj ne shumën prej 64,494.00€, si dhe DETYROHEN Bankat Komerciale në Republikën e Kosovës, që të bëjnë bllokimin e llogarive banakare të NTSH Com Votra, me NRB:80638345, deri në shumën prej 64,494.00€.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë i autorizuari i kundërshtarit të sigurimit, për shkak të shkeljes se dispozitave te procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin

që të aprovohet ankesa e kundërshtarit të sigurimit si e bazuar, të Anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.1002/23 i datës 25.01.2024, dhe çështja të kthehet në procedim të sërishëm.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 194 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i sigurimit Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Shërbimeve Publike, me datën 23.12.2022, pranë gjykatës ka paraqitur padi dhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë për anulimin e faturës së lëshuar ndaj të paditurit/kundërshtarit të sigurimit NTSH Com Votra, ndërsa me parashtresën e dt.17.05.2023 ka bërë precizimin e padisë me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe kundërshtarit të masës së sigurimit, të i bëhet bllokimi i xhirollogarisë bankare, deri në marrjen e vendimit lidhur me kërkesën kryesore.

Në seancën dëgjimore përfaqësuesja e autorizuar e propozuesit deklaron se qëndron pranë propozimit për caktimin e masës së sigurisë, se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 297 i LPK-së, Nga provat e paraqitura propozuesi ka bërë të besueshme se e kzion rreziku se pa caktimin e masës së sigurisë pala kundërshtarë do të pamundësonte apo vështirsonte realizimin e kërkesës, dhe se kundërshtari sigurimit përmes procedurës së përbarimit i ka tërhek mjetet financiare në shumën prej 63,494.00€, pa bazë juridike dhe për punë apo shërbime të cilat nuk i ka kryer dhe për të cilat nuk ka qenë e kontraktuar nga Komuna e Prizrenit, I propozon gjykatës që të aprovoj propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

I autorizuari i kundërshtarit të sigurimit në seancën dëgjimore ka deklaruar se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit si në propozim, Propozuesi i ka pasur të gjitha mundësit që përmes procedurës përbarimore të ushtroj mjetet juridike. Propozuesi nuk e ka bërë të besueshme të drejtën e tij subjektive, nuk ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohej apo vështirsohej realizimi i kërkesës së propozuesit, meqenëse kundërshtari i sigurimit është një biznes i regjistruar dhe veprimtarin e ushtron konform aktivitetit të tij. I propozon gjykatës që të refuzohet propozimi për caktimin e masës së sigurimit.

Dhoma e shkallës së parë lidhur me propozimin e masës së sigurimit, ka mbajtur seancën dëgjimore me datën 25.01.2024, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe ka marrë Aktvendimin e atakuar KE.nr.1002/23 datës 25.01.2024, me të cilin ka Aprovuar si të bazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të këtij vendimi, Dhoma e shkallës së parë, ka dhënë spjegimet ligjore nga neni 297.1 të LPK-së, duke dhënë vlersimin se janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit, sepse propozuesi e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës, ku nga provaat e paraqitura rezulton se kontrata e lidhur mes palëve ndërgjyqëse për ofrimin e

shërbimeve ka qenë me afat të caktuar kohor, ndërsa kundërshtari i sigurimit shumë e kërkuar, veqse e ka realizuar në procedurën përmbartimore, duke u thirrë në shërbimet e ofruara pa kontratë valide ndërmjet tyre. Po ashtu gjykata vleron se është plotësuar edhe kushti i dytë ligjore nga neni 297.1 nen pika (b) të LPK-së, meqenëse ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do të shkaktohej dëm i konsiderueshëm i cili vështirë do të mund të riparohet, nga shkak se kundërshtari i sigurimit veqse i ka realizuar mjetet financiare, dhe i njëjti mund të ndërmarr veprime me të cilat do të mund të pamundësonte apo vështironte realizimin e kërkesës, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i Dhomës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhomat e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji vlerësoi se në ankes kundërshtari i sigurimit nuk ka dhënë pretendime të bazuara për ta ndryshuar aktvendimin e atakuar, pasi që në këtë fazë të procedurës gjyqësore, kundërshtari i sigurimit nuk ka dëshmuar mjaftueshëm me dokumentacion valid, se Caktimi i masës së sigurimit në llogarit e tij bankare dhe Detyrimi për Bankat Komerciale që të bëjnë bllokimin e llogarive të tij bankare, në shumën prej 64,494.00€, do të vështirsohej aktiviteti afarist, duke pasur parasysh se në këtë rast kundërshtari i sigurimit ka realizuar këtë shumë sipas propozimit për përmbartim datës 11.08.2022 dhe Urdhrit përmbartimor P.nr.389/2022 dt.11.08.2022.

Pretendimet ankimore se Dhoma e shkallës së parë nuk i ka vërtetuar faktet vendimtare me rastin e marrjes së vendimit, se aktvendimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, dispozitivi i tij është i pakuptueshëm apo kontradiktor me arsyet e aktvendimit, se nuk janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara me nenin 297 të LPK-së, se bllokimi i llogarive bankare do të pamundësonte funksionimin e biznesit. Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, vlerësoi se vendimi i atakuar i dhomës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nga shqyrtimi i çështjes janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet e përcaktuara me dispozitat e nenit 297 par.1 pika (a) dhe (b), e të cilat i referohen besueshmërisë së kërkesës apo të drejtës subjektive dhe ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do të mund të pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës, ngase propozuesi ka bërë të besueshme dhe të pranueshme propozimin për gjykatën, se lejimi dhe ekzekutimi i përmbartimit me shenjën P.nr.389/2022 dt.11.08.2022 në emër të borxhit në shumën prej 64,494.00€, në emër të faturave dhe kontratës jo valide, do të shkakonte dëm të riparueshëm propozuesit të masës së sigurimit,

andaj në këtë drejtim Dhoma e shkallës së parë me të drejtë e ka aprovuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Kolegji vlerësoi se dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Përfundimisht, Dhomat e Shkallës së Dytë e ka pranuar vlerësimin dhe përfundimin e dhomës së shkallës së parë, pasi që i ka vlerësuar vetëm rrethanat dhe veprimet nga të cilat gjykata mund të nxjerrë besueshmërinë e kërkesës apo të drejtës subjektive, si dhe ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së tillë propozuesit të sigurimit, do ti shkaktohej dëm i pariparueshëm.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, Dhomat e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe nenit 209 pika (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.820/24 datë 11.04.2024

Kryetari i Kolegjit – gjyqtari
Krenar Berisha